



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06  
**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Për:** Gjykatësin e Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Parashtrues:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 18 nëntor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i redaktuar publik i**

**'Raportit mbi arrestimin dhe transferimin e Jakup Krasniqit në objektin e paraburgimit', parashtrimi F00064 i datës 8 nëntor 2020**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**

Dejvid Hupër

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**

Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**

Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

1. Administratorja në vijim i raporton Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi arrestimin dhe transferimin e z. Jakup Krasniqi ("z. Krasniqi") në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("objekti i paraburgimit") në Holandë ("shteti pritës").
2. Ky raport dorëzohet në pajtim me Vendimin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi ("Vendimi")<sup>1</sup>, së bashku me një shtojcë që përmban material mbështetës.<sup>2</sup>

## I. ARRESTIMI

1. Arrestimi i z. Krasniqi u krye nga punonjës të sigurisë operative të ZPS-së, të shoqëruar nga një përkthyes, me mbështetjen logjistike të EULEX Kosovës dhe të policisë së Kosovës.
2. Para kryerjes së arrestimit, punonjësit e ZPS-së dhe përkthyesi morën rezultatet e analizës për koronavirusin e ri ('KOVID-19'), që ishin negative. Punonjësit e sigurisë të ZPS-së dhe përkthyesi mbajtën maska mbrojtëse gjatë gjithë arrestimit dhe transferimit.
3. Afërsisht në orën 6:25 më 4 nëntor 2020, punonjës të ZPS-së arrestuan z. Krasniqi në shtëpinë e tij [REDAKTUAR]. Ata i ranë ziles dhe pastaj, të pasigurt nëse zilja kishte rënë apo jo, trokitën në derën e shtëpisë së z. Krasniqi, të cilën e hapi menjëherë [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. Punonjësi i ZPS-së u prezantua si punonjës policie i ZPS-së me fletarrestim për z. Krasniqi. [REDAKTUAR].
4. Më tej, punonjësi i ZPS-së që do të kryente arrestimin iu prezantua z. Krasniqi me emër dhe si punonjës i ZPS-së. Me ndihmën e përkthyesit, punonjësi arrestues i ZPS-së e informoi z. Krasniqi se ai ishte nën arrest në bazë të fletarrestimit përkatës. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

---

<sup>1</sup> Vendim mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi, KSC-BC-2020-06/F00027, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 48, 49(g).

<sup>2</sup> Shtojca 1, Dosja e arrestim-transferimit, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

5. Punonjësi arrestues i ZPS-së i dorëzoi z. Krasniqi kopje të legalizuara të fletarrestimit (të redaktuar)<sup>3</sup> dhe të urdhrin të transferimit (të redaktuar)<sup>4</sup> në gjuhët angleze dhe shqipe.<sup>5</sup> Në orën 6:39, punonjësi arrestues, në praninë e një punonjësi tjetër të ZPS-së, e informoi z. Krasniqi për arsyen e arrestimit të tij dhe për të drejtat e tij, të cilat iu thanë me zë të lartë në gjuhën angleze dhe iu përkthyen në gjuhën shqipe nga përkthyesi.<sup>6</sup>

6. Punonjësi i ZPS-së e informoi z. Krasniqi, ndër të tjera, se ai ka: të drejtën e përfaqësimit juridik nga një mbrojtës i specializuar i zgjedhur prej tij dhe që t'i caktohet mbrojtës i specializuar pa pagesë nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar mbrojtjen; të drejtën që ai vetë apo dikush tjetër të njoftojë për arrestimin e tij një anëtar të familjes apo një person tjetër të përshtatshëm të zgjedhur prej tij; dhe të drejtën për të heshtur dhe se çfarëdo deklarate e tij do të regjistrohet dhe mund të përdoret si provë. Gjithashtu, punonjësi i ZPS-së i dha z. Krasniqi një kopje në letër të neneve 21 dhe 41(4) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar në gjuhët angleze dhe shqipe, pasi më parë ia lexoi z. Krasniqi të dy nenet në gjuhën angleze, të cilat iu përkthyen në gjuhën shqipe nga përkthyesi. Në orën 6:41, z. Krasniqi nënshkroi konfirmimin se i ishte dhënë informacion për të drejtat e tij.<sup>7</sup>

7. Ndërsa punonjësi arrestues po i lexonte z. Krasniqi të drejtat e tij, një punonjës tjetër i ZPS-së vuri re se z. Krasniqi dukej se po bënte diçka me një telefon mobil që kishte në dorë. Punonjësi i ZPS-së e informoi z. Krasniqi se nuk duhej ta përdorte telefonin në atë moment dhe (me duar me doreza) ia mori. Z. Krasniqi kundërshtoi

---

<sup>3</sup> Version i korigjuar i fletarrestimit për Jakup Krasniqin (i redaktuar), KSC-BC-2020-06/F00027/A07/COR, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; Vendim për autorizim të redaktimeve të përkohshme, KSC-BC-2020-06/F00035, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>4</sup> Version i korigjuar i urdhrin për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (i redaktuar), KSC-BC-2020-06/F00027/A08/COR, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; Vendim për autorizim të redaktimeve të përkohshme, KSC-BC-2020-06/F00035, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>5</sup> Shtojca 1, Fletëdorëzim (i fletarrestimit dhe urdhrin për transferim, të redaktuara).

<sup>6</sup> Shtojca 1, Informacion për të drejtat.

<sup>7</sup> Shtojca 1, Informacion për të drejtat.

dhe punonjësi arrestues me mirësjellje e kujtoi z. Krasniqi se në atë moment ishte i arrestuar. Z. Krasniqi pretendoi se nuk ishte i arrestuar dhe vazhdoi të kundërshtonte duke thënë, “Nuk mund të ma merrni telefonin në këtë mënyrë. Nuk veprohet në këtë mënyrë”. Punonjësi arrestues e siguroi z. Krasniqi se ankesa e tij do të mbahej shënim.

8. Në orën 6:53, punonjësit e ZPS-së kryen një kontroll sigurie pa urdhër kontrolli të z. Krasniqi dhe i nxorën nga xhepat sendet personale, të cilat i vendosën në një qese provash. Edhe telefonin mobil e vendosën në një qese *Faraday* dhe pastaj në një qese provash.

9. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>8</sup>

10. Z. Krasniqi qëndroi në shtëpinë e tij nën ruajtjen e ZPS-së gjatë kohës së kontrollimit të shtëpisë nga punonjës të ZPS-së. Megjithëse fillimisht z. Krasniqi hoqi dorë nga e drejta për të pasur një avokat të pranishëm gjatë kontrollimit, afërsisht në orën 10:30, djali i z. Krasniqi e informoi ekipin e ZPS -së se avokati ishte duke ardhur dhe pas pak avokati mbërriti në vend. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

11. Afërsisht në orën 15:30, punonjës të ZPS-së e transferuan z. Krasniqi nga shtëpia e tij në aeroport. [REDAKTUAR], z. Krasniqi u lejua të merrte me vete një çantë shtesë me disa sende personale. Një letër nga shefi i Zyrës së Mbrojtjes me informacion në lidhje me angazhimin e mbrojtësit dhe kontaktet me familjen (në anglishte dhe shqipe) iu dha avokatit të z. Krasniqi, i cili kopjen në gjuhën shqipe ia dha familjes së z. Krasniqi.<sup>9</sup>

12. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>10</sup> [REDAKTUAR].<sup>11</sup>

13. Afërsisht në orën 17:10, punonjësit e ZPS-së e sollën z. Krasniqi në pikën e transferimit në ruajtje [REDAKTUAR].<sup>12</sup>

14. Z. Krasniqi iu bind punonjësve të ZPS-së gjatë gjithë procesit të arrestimit dhe transferimit, [REDAKTUAR].

---

<sup>8</sup> Shtojca 1, Transferimi në ruajtje (ZPS-Zyra Administrative); Shtojca 1, [REDAKTUAR]; Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit.

<sup>9</sup> Shtojca 1, Letër “Të adresuarit” e shefit të Zyrës së Mbrojtjes, KSC/REG/DEF/0143, 4 nëntor 2020.

<sup>10</sup> Shtojca 1, [REDAKTUAR].

<sup>11</sup> Shtojca 1, [REDAKTUAR].

<sup>12</sup> Shtojca 1, Procesverbal i mbajtjes në ruajtje (ZPS).

## II. TRANSFERIMI

15. Transferimi i z. Krasniqi në ruajtje të Dhomave të Specializuara u zbatua nga koordinatori i sigurisë së misionit ("KSM") i Zyrës Administrative, i shoqëruar nga ekipi përcjellës i Zyrës Administrative. Evidenca e transportimit, që përmban hollësitë e procesit të transferimit, u përgatit në kohë reale nga koordinatori i sigurisë së misionit, dhe origjinali i saj i shkruar me dorë i është bashkëlidhur këtij raporti, së bashku me një kopje të transkriptuar të saj.<sup>13</sup>

16. Para transferimit, koordinatori i sigurisë së misionit dhe anëtarët e ekipit përcjellës morën rezultatet e analizës për KOVID-19, që ishin negative.<sup>14</sup> Gjatë gjithë transferimit, koordinatori i sigurisë së misionit dhe ekipi përcjellës mbajtën maska mbrojtëse dhe doreza, dhe siguruan që edhe zotit Krasniqi t'i jepej maskë mbrojtëse dhe dezinfektues për duar. Gjithashtu, edhe mjetet shtrënguese dhe sipërfaqet e prekshme në aeroplan u pastruan para transferimit.<sup>15</sup>

17. Koordinatori i sigurisë së misionit nënshkroi për transferimin e një çante *Akaru* me sendet personale të z. Krasniqi, me numër regjistrimi M01262242. Koordinatori i sigurisë së misionit konfirmoi se sendet në çantën *Akaru* ishin të sigurta për t'u marrë në aeroplan dhe e vulosi çantën me numrat e vulave 025137, 025139, 025140.<sup>16</sup> Koordinatori i sigurisë së misionit gjithashtu nënshkroi për çantën "ftohëse" të vulosur dhe me numër regjistrimi L00650714, e cila përmbante [REDAKTUAR] sendet [REDAKTUAR] personale [REDAKTUAR].<sup>17</sup> [REDAKTUAR].<sup>18</sup>

---

<sup>13</sup> Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit.

<sup>14</sup> Shtojca 1, Listë kontrolli lidhur me Kovid-19 (Transferimi).

<sup>15</sup> Shtojca 1, Listë kontrolli lidhur me Kovid-19 (Transferimi).

<sup>16</sup> Shtojca 1, Transferimi në ruajtje (ZPS-Zyra Administrative)

<sup>17</sup> Shtojca 1, Shtojca 1, Transferimi i mbajtjes në ruajtje (ZPS-Zyra Administrative); Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit.

<sup>18</sup> Shtojca 1, Shtojca 1, Transferimi në ruajtje (ZPS-Zyra Administrative); Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit ; Shtojca 1, [REDAKTUAR].

18. Në orën 17:49, pasi konfirmoi identitetin e z. Krasniqi, koordinatori i sigurisë së misionit nënshkroi transferimin e z. Krasniqi nga ZPS-ja në ruajtje të Dhomave të Specializuara.<sup>19</sup>
19. Në vijim, koordinatori i sigurisë së misionit i shpjegoi z. Krasniqi procesin e transferimit [REDAKTUAR].<sup>20</sup>
20. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>21</sup>
21. Në orën 18:25, aeroplani u nis [REDAKTUAR]. Gjatë tranzitit, zotit Krasniqi iu ofrua ushqim dhe ujë, por ai nuk pranoi.<sup>22</sup>
22. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>23</sup>
23. Në orën 19:05, koordinatori i sigurisë së misionit i dorëzoi z. Krasniqi kopje të legalizuar të Aktakuzës (së redaktuar më tej)<sup>24</sup> në anglishte dhe në shqipe.<sup>25</sup> Z. Krasniqi nënshkroi fletëdorëzimin, por nuk pranoi të merrte kopjen e legalizuar të Aktakuzës (së redaktuar më tej).<sup>26</sup>
24. [REDAKTUAR].
25. Në orën 20:00, Administratorja njoftoi Ambasadën e Republikës së Kosovës në Hagë se z. Krasniqi po transferohej në objektin e paraburgimit në shtetit pritës, në përputhje me fletarrestimin dhe urdhrin e transferimit.<sup>27</sup>
26. Në orën 20:46, z. Krasniqi iu ofrua përsëri diçka për të pirë, por ai nuk pranoi. Ai megjithatë pranoi të merrte një maskë mbrojtëse të re dhe dezinfektues për duar.<sup>28</sup>
27. Në orën 21:10, aeroplani u ul [REDAKTUAR].
28. Në orën 21:19, koordinatori i sigurisë së misionit e shoqëroi z. Krasniqi [REDAKTUAR] dhe e transferoi atë në ruajtje të Shërbimit të Transportit dhe

---

<sup>19</sup> Shtojca 1, Transferimi në ruajtje (ZPS-Zyra Administrative); Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit .

<sup>20</sup> Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit ; Shtojca 1, fotografi ( në pikën e transferimit).

<sup>21</sup> Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit.

<sup>22</sup> Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit.

<sup>23</sup> Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit.

<sup>24</sup> Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00034/A03, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>25</sup> Shtojca 1, Fletëdorëzim (i Aktakuzës së redaktuar më tej).

<sup>26</sup> Shtojca 1, Fletëdorëzim (i Aktakuzës së redaktuar më tej); Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit.

<sup>27</sup> Notë Verbale, nr. KSC/NV2020/0051, 4 nëntor 2020.

<sup>28</sup> Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit.

Mbështetjes të Holandës (“DV&O”), së bashku me [REDAKTUAR] dy çantat me sende personale, M01262242 dhe L00650714, si edhe kopjen e legalizuar të Aktakuzës (së redaktuar më tej) të z. Krasniqi.<sup>29</sup> Shërbimi i Transportit dhe Mbështetjes i Holandës u nis [REDAKTUAR] në orën 21:40.

29. Në orën 21:55, z. Krasniqi mbërriti në objektin e paraburgimit dhe Shërbimi i Transportit dhe Mbështetjes i Holandës e transferoi z. Krasniqi në ruajtje të shefit të paraburgimit.<sup>30</sup> [REDAKTUAR].

30. [REDAKTUAR].<sup>31</sup> [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR] më pas u krye procedura e pranimit të z. Krasniqi në objektin e paraburgimit në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit.

31. Pas mbërritjes së z. Krasniqi në objektin e paraburgimit, shefi i paraburgimit njoftoi pa vonesë Administratoren, e cila menjëherë njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake<sup>32</sup> dhe shefin e Zyrës së Mbrojtjes në përputhje me rregullën 10 të Rregullores së Paraburgimit, si edhe Kryetaren dhe Avokatin e Popullit. Administratorja njoftoi gjithashtu edhe Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.<sup>33</sup>

32. [REDAKTUAR], shefi i paraburgimit kreu intervistën e mbërritjes me z. Krasniqi, me ndihmën e një përkthyesi. Gjatë intervistës së mbërritjes, zotit Krasniqi iu dhanë të dhënat e kontaktit të zyrës konsullore të tij dhe iu ofrua mundësia për të kontaktuar me telefon [REDAKTUAR]. Përpara se të largohej nga z. Krasniqi atë mbrëmje, shefi i paraburgimit u siguroi që z. Krasniqi të kishte një kopje të legalizuar të Aktakuzës (së redaktuar më tej).

33. Të nesërmen në mëngjes, më 5 nëntor 2020, shefi i njësisë së paraburgimit vazhdoi intervistën e mbërritjes me z. Krasniqi. Gjatë asaj interviste, zotit Krasniqi iu

---

<sup>29</sup> Shtojca 1, Kërkesë për transportimin nga aeroporti dhe transferimin e personit të paraburgosur; Shtojca 1, Evidencë e transportimit të të paraburgosurit; Shtojca 1, [REDAKTUAR].

<sup>30</sup> Shtojca 1, Kërkesë për transportimin nga aeroporti dhe transferimin e personit të paraburgosur.

<sup>31</sup> Shtojca 1, [REDAKTUAR].

<sup>32</sup> *Shih*, Njoftim i pranimit të Jakup Krasniqit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, KSC-BC-2020-06/F00048, 4 nëntor 2020.

<sup>33</sup> *Shih* Marrëveshje ndërmjet Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq mbi vizitat te personat që u është hequr liria në përputhje me juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 28 janar 2019, para. 12(2).

dhanë informacionet dhe dokumentet e përmendura në rregullën 12.3 të Rregullores së Paraburgimit.

34. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

35. Nga ora 10:05 deri në 10:30, shefi i Zyrës së Mbrojtjes foli me z. Krasniqi përmes videolidhjes, me ndihmën e një përkthyesi. Shefi i Zyrës së Mbrojtjes i dha z. Krasniqi informacion dhe dokumente lidhur me disponueshmërinë e ndihmës juridike në bazë të rregullës 12.2 të Rregullores së Paraburgimit dhe konfirmoi se zyra e administrimit e njësisë së paraburgimit i kishte dhënë z. Krasniqi të gjitha dokumentet përkatëse lidhur me ndihmën juridike, si dhe një letër, në anglishte dhe në shqipe, ku shpjegohej e drejta e tij për të pasur mbrojtës.<sup>34</sup> Shefi i Zyrës së Mbrojtjes gjithashtu e informoi z. Krasniqi se atij i ishte emëruar një mbrojtës kujdestar nga Administratorja, në rast se dëshironte të këshillohej me mbrojtësin kujdestar në atë kohë. [REDAKTUAR].

36. Më vonë atë ditë, z. Krasniqi mori sendet personale të tij.

37. Në orën 16:20, shefi i paraburgimit i dorëzoi z. Krasniqi kopje të legalizuara të versioneve të korrigjuara të fletarrestimit (të paredaktuar),<sup>35</sup> të urdhrit të transferimit (të paredaktuar),<sup>36</sup> dhe të vendimit për kontrollim dhe sekuestrim (të paredaktuar),<sup>37</sup> në gjuhët angleze dhe shqipe.<sup>38</sup>

---

<sup>34</sup> Shtojca 1, Letër për të Akuzuarin nga shefi i Zyrës së Mbrojtjes, KSC/REG/DEF/0139, 4 nëntor 2020.

<sup>35</sup> Version i korrigjuar i fletarrestimit për Jakup Krasniqin, KSC-BC-2020-06/F00027/A07/COR, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; Vendim për autorizim të redaktimeve të përkohshme, KSC-BC-2020-06/F00035, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>36</sup> Version i korrigjuar i urdhrit për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, KSC-BC-2020-06/F00027/A08/COR, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; Vendim për autorizim të redaktimeve të përkohshme, KSC-BC-2020-06/F00035, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>37</sup> Version i korrigjuar i vendimit për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit, KSC-BC-2020-06/F00031/COR, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; Vendimi për autorizim të redaktimeve të përkohshme, KSC-BC-2020-06/F00035, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>38</sup> Shtojca 1, Fletëdorëzim (i fletarrestimit, urdhrit për transferim dhe vendimit për kontrollim dhe sekuestrim, të paredaktuara); Shtojca 1, Evidencë e DHSK-së për dorëzimin e dokumenteve (5 nëntor 2020).



38. Në orën 19:30, shefi i paraburgimit i dorëzoi z. Krasniqi kopje të legalizuar të Aktakuzës (së korrigjuar dhe të redaktuar),<sup>39</sup> në gjuhët angleze dhe shqipe.<sup>40</sup>

39. Ditën e nesërme, më 6 nëntor 2020, në orën 10:20, z. Krasniqi u takua përsëri me shefin e Zyrës së Mbrojtjes [REDAKTUAR]. Po atë ditë, përmes shefit të Zyrës së Mbrojtjes, z. Krasniqi i parashtrori Administratores një kërkesë për emërimin e znj. Venkatesvari Alagenda si Mbrojtëse të tij dhe nënshkroi aktin e përfaqësimit.

40. Më 6 shtator 2020, Administratorja emëroi znj. Venkatesvari Alagenda si Mbrojtëse të z. Krasniqi.<sup>41</sup>

### III. KLASIFIKIMI

41. Ky raport dorëzohet si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në përputhje me klasifikimin e KSC-BC-2020-06/F00027, së bashku me një shtojcë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

42. Para një riklasifikimi, Administratorja kërkon t'i jepet mundësia që t'i dorëzojë Gjykatësit të Procedurës Paraprake versionet publike, të redaktuara dhe/ose konfidenciale të parashtrimit themelor dhe shtojcës së tij, për të mbrojtur, ndër të tjera: konfidencialitetin e operacioneve dhe hetimeve; informacionin në lidhje me transportin e sigurt të të paraburgosurve; informacionin identifikues të punonjësve ose kontraktorëve të ZPS-së dhe Zyrës Administrative; dhe/ose [REDAKTUAR].

**Numri i fjalëve (në origjinal): 2326**

/nënshkrim/

---

**Dr. Fidelma Donlon**

**Administratore**

---

<sup>39</sup> Aktakuza (e korrigjuar dhe e redaktuar), KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; Vendim për autorizimin e shtyrjes së dorëzimit të Aktakuzës së korrigjuar dhe të redaktuar, KSC-BC-2020-06/F00046, 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>40</sup> Shtojca 1, Fletëdorëzim (i Aktakuzës së korrigjuar dhe të redaktuar ); Shtojca 1, Evidencë e DHSK-së për dorëzimin e dokumenteve (5 nëntor 2020).

<sup>41</sup> Njoftim për emërimin e mbrojtësit, KSC-BC-2020-06, 6 nëntor 2020.

E mërkurë, 18 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë